



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2024

VENDIM

Nr. 7, datë 25.03.2024

PËR
PËR MIRATIMIN E “PASQYRAVE FINANCIARE
TË “FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME”
PËR VITIN 2023”

Në bazë dhe në zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “m/1” të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, nenit 71, pika 2, të nenit 73, pika 1, dhe të nenit 79 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenin 15, pika 1 dhe pika 5 dhe të nenit 18 pika 1 të Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të miratuar me Vendimi të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 3.10.2017, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “c”, të nenit 8, pika 2, shkronja “l” të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë pasqyrat financiare të “Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” për vitin 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi në Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
3. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës të Riskut për zbatimin e këtij vendimi.





4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

